

Orion Shima & Martin Stommel

Side by Side

7 Tetor > 14 Nentor 2020

Eventi i Hapjes , 7 tetor , duke filluar nga ora 6

Rruga Abdi Toptani ne Toptani Shopping Center

**Ndërmjet jetës dhe botës***Miti i natyrës dhe natyra e mitit*

Në shikim të parë, te veprat e Stommel-it dhe Shimës mund të pikasim një lloj ndjeshmërie mitologjike në lidhje me marrëdhënien e njeriut me natyrën. Për t'u shprehur me metaforë, le të themi se janë dy rryma të ndryshme që bëhen bashkë në kërkim të detit.

Ata nuk e zgjedhin peizazhin si hapësirë apo sfond ku qëndrojnë personazhe të caktuar; përkundrazi, ai është po aq i rëndësishëm sa personazhet. Qasja e dy autorëve ndaj natyrës evokon një gjendje idilike, parajsore, ose – siç e përmendëm – mitike, ose të trija njëherësh, sepse në thelb janë “sublimime” të udhëtimit njerëzor nga këtu për atje. E thënë ndryshe, peizazhet e tyre nuk janë normalë, ose nuk janë të mundur “këtu dhe tani”.

Shtigjet drejt këtyre vendeve “magjike”, me sa duket i dinë vetëm personazhet që i banojnë këto hapësira. Ata na shfaqen herë të tensionuar, herë të trishtë e herë të shpenguar. Ata pothuajse bëhen njësh me natyrën, sikur ajo është zgjatim i tyre, ose anasjelltas. Po ashtu, mund të shihen edhe si të arratisur nga shoqëria, nga qyteti, tregu, trafiku dhe çdo gjë tjetër që bëhet në emër të progresit, për të ndenjur pak me veten, ose për ta kërkuar atë nëpërmjet ritualit, që është tipik në natyrë; jo aksionit, që është tipik për progresin, për utopinë.

Shprehia e fytyrës dhe e trupit të personazheve në natyrë e sipër, si te Stommel-i ashtu dhe te Shima, në të shumtë shfaqet si “asnjanëse”, domethënë kemi të bëjmë me një gjendje ndërmjet komedisë dhe tragjedisë, pikërisht me dramën. Ata mbartin atë dramë që mund të përmblihet në togfjalëshin *natyra nuk mjafton*, sepse njeriu nuk është bir apo bijë e natyrës. Po të ishte e mjaftueshme natyra, po të ishte shtëpia jonë, parajsa jonë e humbur apo e premtuar, atëherë nuk do të provonim e përjetonim ankth, ose ndjenën e të qenurit të huaj. Në shtëpinë tonë nuk ndihemi në siklet, as të huaj, ndërsa në një tjetër po. Ankthi është i pashmangshëm, edhe në natyrë, pavarësisht trajtave të ndryshme me të cilat na mbërthen.

Në fakt, Mesdheu ka patur një traditë (greko-romake) e cila e “kuronte” ankthin me hedonizëm, domethënë duke e shmangur, duke e harruar, gjë që vazhdon edhe sot e kësaj dite, por në forma të tjera. Ama ankthi mbetet, çfarëdo që të bëjmë ne. Çështja nuk është as ta shmangësh, as ta luftosh dhe as ta hyjnizosh, por të bashkëjetosh me të duke e ekuilibruar me dashurinë.

Edison Çeraj

Kerkesa per imazhe: press@gallery70.art

@gallery70



@gallery70